

Informacione për prindërit dhe punonjësit e fushës së formimit në kantonin e Vaudit – Koronavirusi (Covid-19)

Përditësim i informacionit

Kjo faqe, që u kushtohet qendrave të formimit, shkollave dhe institucioneve të pritjes kolektive ditore para dhe pas-shkollore, përditësohet sipas zhvillimit të gjendjes. [Konsultoni versionin frëngjisht.](#)

Versioni i 31 gushtit ora 15.25.

Arsimi i detyrueshëm:

Si do të bëhet fillimi i vitit shkollor më 24 gusht në shkollën e detyrueshme?

Në mënyrë sa më normale të mundshme pavarësisht nga rrethanat. Gjendja sanitare na mundëson një rifillim me klasa të plota, gjë që nxit lidhjet shoqërore dhe barazinë e mundësive, ndryshe nga gjysmë-klasat dhe mësimdhënia në largësi.

Për më tepër informacione:

- [Komunikatë shtypi e 18 gushtit 2020](#)

Çfarë do të bëhet me fëmijët që kanë boshllëqe në mësim?

Do të bëhet një vlerësim prej mësuesve gjatë javëve të para të mësimit. Prindërit do të marrin një bilanc për secilin fëmijë. Po qe nevoja, do të merren masa individuale apo kolektive për plotësimin e boshllëqeve.

Si të sillemi në institucionet vaudeze të formimit ?

Nouveau coronavirus Actualisé au 3.6.2020

VOICI COMMENT NOUS PROTÉGER: 

Suivre impérativement les nouvelles règles :

✓ **Test**



En cas de symptômes, se faire tester tout de suite et rester à la maison.

✓ **Traçage**



Chaque fois que c'est possible, fournir ses coordonnées pour le traçage.

✓ **Isolement/quarantaine**



En cas de test positif : isolement.
En cas de contact avec une personne testée positive : quarantaine.

Pour rappel :

✓ 

Garder ses distances.

✓ 

Recommandé : un masque si on ne peut pas garder ses distances.

✓ 

Se laver soigneusement les mains.

✓ 

Éviter les poignées de main.

✓ 

Tousser et éternuer dans un mouchoir ou dans le creux du coude.

✓ 

Toujours téléphoner avant d'aller chez le médecin ou aux urgences.

✓ 

Si possible, continuer de travailler à la maison.

www.ofsp-coronavirus.ch



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Bundesamt für Gesundheit BAG
Office fédéral de la santé publique OFSP
Ufficio federale della sanità pubblica UFSP
Uffizi federal da sanadad publica UFSP



Scan for translation

Gjithë nxënësve e gjithë punonjësve të pranishëm në vendet e formimit do t'u rikujtohen këshillat bazë. Ato janë vënë në dukje në të gjitha institucionet përmes afishes zyrtare të OFSP-së :

- është e nevojshme të lahen duart me ujë e sapun, rregullisht e me kujdes;
- duhet të shmangët shtrëngimi i duarve ;
- duhet të mbahet largësia e të shmangën kontaktet fizike të afërta;
- mbajtja e maskës është e detyrueshme për të rriturit apo mësuesit ;
- mbajtja e maskës, në hapësirat e përbashkëta gjatë të gjitha lëvizjeve brenda ndërtesave, si dhe në klasa, është e detyrueshme për mësuesit dhe punonjësit e tjerë të shkollës. Në klasë,

kur largësia më e vogël prej 1.5 m mund të respektohet, maska mund të hiqet. Maskat kirurgjikale të hedhshme, që sigurohen nga punëdhënësi përmes institucionit, duhet të ndërrohen dy herë në ditë ;

- duhet kollitur e tështitur në shami ose në të thelluarën e bërrylit ;
- në rast pranije të shenjave (shih [FAQ-un e Mjekut kantonal](#)), i rrituri apo fëmija përkatës duhet të rrijë në shtëpi dhe të kontaktojë mjekun e vet trajtues.

Nxënësit e mbajnë maskën vetëm në rastet e mëposhtme :

- nxënësit e moshës mbi 12 vjeç që përdorin transportet publike në kuadrin shkollor ;
- nxënësit e institucioneve shkollore të specializuara që ndjekin mësimet në strukturat kalimtare (maskat i marrin prej strukturave kalimtare) ;
- nxënësit e RAC-së I dhe RAC-së II në çdo kohë në shkollë (maskat i marrin prej institucioneve).

Për më tepër informacione:

- [Vendimi 178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispositions d'application relatives aux mesures sanitaires et organisationnelles..." ["Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."]
- [Sit për](#) këshillat dhe telengarkimin e afishes « Koronavirusi i ri : ja si të mbrohemi »
- Në mënyrë argëtuese, mund t'i forcojmë gjestet mbrojtëse duke luajtur [me CoronaQuest - in](#) në linjë

Ç'masa janë marrë për të mbrojtur punonjësit e fushës së formimit?

- Pllakate plastike të tejdukshme janë vendosur në sportele ;
- Vendet e punës të secilit janë sistemuar në mënyrë të tillë që të ruhet largësia prej 1,5 m midis të rriturve në sallat e mësuesve, Ku hyrja bëhet me radhë ;
- Në dispozicion të punonjësve janë vënë maska ;
- Koshat e plehrave zbrazen një herë në ditë ;
- Shpërndarja e materialeve duhet të bëhet prej nxënësve, në vend të mësuesve ;
- Enët, ushqimi dhe pijet nuk duhet të ndahen midis të rriturve, midis fëmijëve, apo midis të rriturve e fëmijëve.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi 178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

A do të zhvillohet mësimi i edukimit fizik?

Po, por duke respektuar [direktivat](#) e Shërbimit të edukimit fizik e të sportit (SEPS). Në mënyrë të përmbledhur:

- Veprimtaritë në ajër të pastër janë përparësore;

- Ushtrimet që kërkojnë përdorimin e mjeteve të sigurimit shmangen;
- Sportet me kontakt (mundja, ndeshjet e boksit etj.) ndalohen;
- Dushet dhe gardërobat janë të hapura dhe dezinfektohen të paktën 1 herë në ditë.

Kurset e këngës, a zhvillohen në shkollën e detyrueshme?

- nxënësit e klasave 1P – 11S mund t'i ndjekin kurset e këngës;
- mësimi për nxënësit e RAC-së dhe të klasës së 12të duhet të përshtatet (kursi i këngës mund të ndiqet por duhet të mbahet largësia 1.5 m). Në mungesë të një lokali me madhësi të mjaftueshme, duhet të gjenden mënyra të tjera (mësimi i këngës në natyrë, sallë më e madhe, etj.);
- mësuesi mban maskë, nëse respektimi i largësisë është i pamundur (po ashtu edhe kolegët e tij).

Në ç'kushte kryhen pushimet midis orëve?

Pushimet midis orëve kryhen normalisht për të gjithë nxënësit. Nuk duhet të ketë ndarje ushqimi dhe pijesh midis të rriturve, midis fëmijëve dhe midis të rriturve dhe fëmijëve.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n° 178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

Në ç'kushte kryhet dalja nga shkolla në mbarim të mësimëve?

Në mbarim të mësimëve, fëmijët largohen menjëherë nga oborri i shkollës ose shkojnë në veprimtaritë pas-shkollore. Të rriturit që nuk merren drejtpërdrejt me veprimtarinë shkollore, për shembull prindërit që bien fëmijët në shkollë, duhet të shmangin qëndrimin në rrethinat e ndërtesës së shkollës. Po ashtu, të rriturit dhe/apo prindërit duhet të shmangin grumbullimin në afërsi të shkollës. Të rriturit që duhet të hyjnë patjetër në oborrin apo ndërtesën e shkollës duhet të mbajnë maskë.

Më shumë informacione:

- [Vendimi n°178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

A dezinfektohen klasat dhe ndërtesat?

Dezinfektimi i klasave bëhet të paktën një herë në ditë për sa u përket lokaleve, sipërfaqeve, tavolinave të nxënësve dhe tavolinave të mësuesve. Dorezat e dyerve dhe dritareve, çelësat

e dritave dhe rubinetat duhet të dezinfektohen më rregullisht, të paktën dy herë në ditë. Pastrimi i dysHEMEVE bëhet 2 herë në javë me produktet e zakonshme.

Në hyrje të sekretarive, të sallave të mësuesve, bibliotekave dhe vendeve të tjera publike apo hapësirave të përbashkëta, janë vendosur pajisje të posaçme shtesë për higjienën e duarve. Në rast pamjaftueshërie të duarlarësve në ndërtesë, nxënësit mund të përdorin lëng hidro-alkoolik, por nën mbikëqyrjen e një të rrituri.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

A janë të hapura mensat, lokalet e pritjes pas-shkollore dhe sallat e detyrave me mbikëqyrje?

Ato janë të hapura, por merren masa higjiene të posaçme.

Për lokalet e përdorura për pritjen pas-shkollore fillore, janë dhënë direktiva prej [OAJE-së](#).

Lokalet e detyrave me mbikëqyrje u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përgjithshme të largësisë dhe higjienës si edhe arsimi i detyrueshëm.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

Transportet shkollore, a bëhen si zakonisht?

Po. Të rriturit duhet të mbajnë maska që u jepen prej punëdhënësit. Nxënësit e shkollës së detyrueshme nuk janë të detyruar të mbajnë maskë.

Përkundrazi, në transportet publike (autobus linje, tren, etj.) fëmijët qysh nga mosha 12 vjeç duhet të mbajnë maska.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

Çfarë duhet bërë nëse dikush (nxënës apo mësues) paraqet shenja në klasë?

Në rast se paraqet shenja (shih [FAQ-në e Mjekut kantonal](#)), nxënësi:

- del nga klasa ;
- pajiset me maskë ;
- pret prindërit ose kthehet vetë në banesë (sipas moshës) ;
- prindërit kontaktojnë mjekun e fëmijëve ose "hotline"-ën e Kantonit.

Punonjësi i trupit mësimor:

- del nga klasa dhe izolohet;
- mban maskën ;
- kthehet në shtëpi ;
- kontakton mjekun e vet ose "hotline"-ën e Kantonit.

Rezultati i testit të një nxënësi apo mësuesi nuk i transmetohet institucionit shkollor për shkak të ruajtjes së sekretit mjekësor.

Sa vetë mund të shkojnë në të njëjtën kohë në sallën e mësuesve?

Numri i atyre që mund të gjenden në të njëjtën kohë në sallën e mësuesve duhet të jepet qartësisht në hyrje të saj e ai numër nuk mund të kalojë. Në çdo kohë, nëse largësia 1,5 m nuk mund të mbahet, cilido që hyn në sallën e mësuesve duhet të mbajë maskë mbrojtëse.

Si duhet të sillemi kur kthehemi nga një vend me rrezik?

Nxënësit, mësuesit, punonjësit administrativë e teknikë, që kthehen nga një udhëtim në një zonë apo vend të klasifikuar si « me rrezik » prej autoriteteve federale, ndjekin me përpikëri udhëzimet e dhëna nga OFSP-ja (lista e vendeve me rrezik dhe rendi i veprimeve që duhet ndjekur në www.bag.admin.ch). Ata vendosen në vetizolim, kontaktojnë Mjekun kantonal dhe kthehen në institucionin e tyre vetëm pasi të ketë mbaruar koha e izolimit në fjalë dhe vetëm nëse nuk paraqesin asnjë shenjë. Mësuesit dhe drejtoritë nuk marrin masa ndaj nxënësve që mungojnë për shkak të vënies në karantinë.

Më shumë informacione:

- [Vendimi n°178 \(PDF, 4,49 Mo\)](#): "Dispozitat e zbatimit lidhur me masat sanitare dhe organizative..."

Arsimi i mesëm:

Si do të bëhet fillimi i vitit shkollor më 24 gusht në shkollën e mesme?

Në mënyrë sa më normale të mundshme pavarësisht nga rrethanat. Fillimi i vitit shkollor më 24 gusht bëhet në praninë e nxënësve në institucionin e tyre shkollor, me klasa të plota, me masa sanitare shoqëruese. Kjo nxit lidhjet shoqërore dhe barazinë e mundësive, ndryshe nga gjysmë-klasat dhe mësimdhënia në largësi.

Për më tepër informacione:

- [Komunikatë shtypi e 18 gushtit 2020](#)
- [Vendimi n°174 \(PDF, 414 Ko\)](#): "Dispositions d'application des mesures sanitaires et organisationnelles dans le cadre de la reprise de l'enseignement présentiel et de la tenue d'exams dès le 10 août 2020 au niveau secondaire II (Plan de protection cantonal 2 du secondaire II - COVID-19). " ["Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."]

Çfarë do të bëhet me nxënësit që kanë boshllëqe në mësim?

Në planin pedagogjik, qysh me fillimin e vitit shkollor më 24 gusht janë propozuar masa mbështetëse që mundësojnë plotësimin e boshllëqeve të shkaktuara nga gjysmë-izolimi .

Për më tepër informacione:

- [Komunikatë shtypi e 18 gushtit 2020](#)

Si të sillemi në institucionet vaudeze të formimit ?

Nouveau coronavirus Actualisé au 3.6.2020

VOICI COMMENT NOUS PROTÉGER: 

Suivre impérativement les nouvelles règles :

✓ **Test**



En cas de symptômes, se faire tester tout de suite et rester à la maison.

✓ **Traçage**



Chaque fois que c'est possible, fournir ses coordonnées pour le traçage.

✓ **Isolement/quarantaine**



En cas de test positif : isolement.
En cas de contact avec une personne testée positive : quarantaine.

Pour rappel :

✓ 

Garder ses distances.

✓ 

Recommandé : un masque si on ne peut pas garder ses distances.

✓ 

Se laver soigneusement les mains.

✓ 

Éviter les poignées de main.

✓ 

Tousser et éternuer dans un mouchoir ou dans le creux du coude.

✓ 

Toujours téléphoner avant d'aller chez le médecin ou aux urgences.

✓ 

Si possible, continuer de travailler à la maison.

www.ofsp-coronavirus.ch



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Bundesamt für Gesundheit BAG
Office fédéral de la santé publique OFSP
Ufficio federale della sanità pubblica UFSP
Uffizi federal da sanadad publica UFSP



Scan for translation

Gjithë nxënësve e gjithë punonjësve të pranishëm në vendet e formimit do t'u rikujtohen këshillat bazë. Ato janë vënë në dukje në të gjitha institucionet përmes afishes zyrtare të OFSP-së, si vijon:

- është e nevojshme të lahen duart me ujë e sapun, rregullisht e me kujdes ;
- duhet të shmangët shtrëngimi i duarve ;
- duhet të mbahet largësia / të shmangën kontaktet fizike të afërta;

- është e detyrueshme për nxënësit, mësuesit dhe tërë punonjësit e administratës që të mbajnë maskë gjatë tërë kohës që kalojnë në ndërtesa ashtu si edhe në hapësirat e jashtme të institucionit shkollor;
- Vetëm mësuesit që qëndrojnë përballë klasës e më larg se 1.5 m nga nxënësit mund ta heqin maskën, por ajo duhet të mbahet patjetër sapo largësia 1.5 m nuk mund të mbahet më. Maskat kirurgjikale të hedhshme, që jepen prej punëdhënësit përmes institucionit, duhet të ndërrohen dy herë në ditë;
- duhet kollitur e tështitur në shami ose në të thelluarën e bërrylit ;
- në rast pranije të shenjave (shih FAQ-në e Mjekut kantonal), i rrituri apo fëmija përkatës duhet të rrijë në banesën e vet dhe të kontaktojë mjekun trajtues.

Për më tepër informacione:

- [Sit për](#) këshillat dhe telengarkimin e afishes « Koronavirusi i ri : ja si të mbrohemi »
- Në mënyrë argëtuese, mund t'i forcojmë gjestet mbrojtëse duke luajtur [me CoronaQuest - in](#) në linjë

Ç'rregulla sanitare duhet të zbatohen nxënësit dhe punonjësit e arsimit të mesëm?

Mbajtja e maskës është e detyrueshme për nxënësit, për mësuesit dhe tërë punonjësit administrativë e teknikë gjatë tërë kohës që kalojnë në ndërtesat e shkollave profesionale dhe gjimnazet, ashtu si edhe në hapësirat e jashtme.

Çdo nxënës e çdo punonjës i lan duart të paktën kur vjen dhe kur largohet nga institucioni shkollor, po ashtu edhe sa herë ndërron lokal dhe sa herë përdor një material të përbashkët.

Rregullat e largësisë shoqërore dhe hapësinore të rekomanduara (1,5 metra njeriu nga njeriu) duhet të respektohen midis të rriturve, midis të rriturve dhe nxënësve dhe midis nxënësve, edhe në sallën e mësuesve sa herë që të jetë e mundur.

Hollësitë e të gjitha rregullave sanitare të caktuara gjenden në vendimin departamental n° 174.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n° 174 \(PDF, 414 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit hapa pas hapi të mësimdhënies me prani në klasë në nivelin e shkollës së mesme II (Plani i mbrojtjes kantonale i arsimit të mesëm II - COVID-19)"

A duhet që nxënësit e shkollave të përgjithshme dhe profesionale të pajisen me maska dhe t'i mbajnë ato?

Të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme e profesionale duhet të pajisen me maska, gjatë tërë kohës që kalojnë në ndërtesat shkollore si dhe në hapësirat jashtë institucionit dhe ta ndërrojnë atë dy herë në ditë. Gjatë dy javëve të para pas fillimit të vitit shkollor më 24 gusht, shpërndahen maska me qëllim nxitës.

Qysh nga 7 shtatori 2020:

- nxënësit e shkollave të përgjithshme e profesionale duhet t'i sigurojnë vetë maskat me mjetet e tyre;
- nxënësit e shkollave të përgjithshme e profesionale gjendja ekonomike e shoqërore e të cilëve e bën të vështirë sigurimin e maskave mund t'i kërkojnë drejtorisë që t'i pajisë me dy maska kirurgjikale të hedhshme çdo ditë që janë të pranishëm në klasën e tyre në institucionin shkollor.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°174 \(PDF, 512 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."

A do të zhvillohet mësimi i edukimit fizik?

Mësimi i sportit në sallë mund të bëhet pa maskë me kusht që largësia hapësinore prej 1,5 m të ruhet në mënyrë sistematike e në çdo kohë midis nxënësve dhe midis nxënësve dhe mësuesit. Në këtë kuptim, praktikimi i sporteve kolektive me kontakt fizik (futboll, basketboll, lojëra me top, etj.) është i ndaluar. Materialet (pajisjet) dezinfektohen pas çdo mësimi të dhënë.

Gardërobat, me përjashtim të zonave me lagështi që mbeten të mbyllura për arsye sanitare. Mbjajtja e maskës është e detyrueshme në korridore e në gardëroba.

A mbahen kurset e këngës në shkollat e mesme?

Mësimdhënia e këngës është e mundur, por jo praktikimi i këngës në grup.

A dezinfektohen klasat dhe ndërtesat?

- Lokalet ajrosen pas çdo përdorimi;
- institucionet pajisen me material sanitar;

- lokalet, sipërfaqet, tavolinat e nxënësve dhe të mësuesve, çelësat e dritave, dorezat e dyerve e të dritareve, rampat dhe infrastrukturat sanitare pastrohen **dy herë në ditë** nga punonjësit e pastrimit;
- nxënësit pastrojnë tavolinat dhe karriget e tyre para se të dalin nga klasa. Material dezinfektues është vënë në dispozicion;
- koshat e plehrave zbrazen të paktën dy herë në ditë;
- hiqet çdo material që nuk mund të lahet apo dezinfekohet;
- dyshemetë pastrohen nga punonjësit e pastrimit një herë në ditë.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°174 \(PDF, 512 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."

Si bëhet ngrënia në kafeteritë dhe restorantet shkollore?

Vaktet mund të merren me grupe deri në gjashtë vetë, duke ruajtur largësinë shoqërore e hapësinore prej të paktën 1,5 m midis çdo grupi njerëzish. Regjistrimet bëhen paraprakisht, duke njoftuar përbërjen e grupit që nuk mund të ndryshohet për arsye të gjurmimit të rasteve. mbajtja e maskës nuk është e nevojshme për sa kohë që anëtarët e grupit qëndrojnë të ulur në tryezën e tyre. Ajo bëhet e detyrueshme sapo ata largohen nga tryeza. Vendosja e mbajtëseve me lugë, pirunë e thika për vetëshërbim është e ndaluar. Punonjësit, ashtu si edhe nxënësit, tregojnë kujdes që të mos i shkëmbejnë lugët e pirunët e të mos e ndajnë ushqimin midis tyre.

Më shumë informacione:

- [Vendimi n°174 \(PDF, 414 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."

Çfarë bëhet kur një i ri në shkollë të mesme profesionale apo një punonjës i formimit profesional paraqet shenja?

Në rast se paraqet shenja (shih [FAQ-në e Mjekut kantonal](#)), nxënësi apo punonjësi i formimit :

- del nga klasa ;
- kthehet në banesë me mjetet e veta ;
- bën një [CoronaCheck](#) dhe, sipas rezultatit, shkon në një qendër testimi COVID-19 ose kontakton mjekun e tij trajtues

Rezultati i testit të një nxënësi apo mësuesi nuk i transmetohet institucionit shkollor për shkak të ruajtjes së sekretit mjekësor. Hollësitë e masave që duhen marrë në rast shenjash (izolim) dhe test COVID-19 pozitiv (gjurmimi i rasteve) jepen në vendimin 174.

Për më tepër informacione:

- [Vendimi n°174 \(PDF, 414 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."

Si duhet të sillemi kur kthehemi nga një vend me rrezik?

Nxënësit, mësuesit, punonjësit administrativë e teknikë, që kthehen nga një udhëtim në një zonë apo vend të klasifikuar si « me rrezik » prej autoriteteve federale, ndjekin me përpikëri udhëzimet e dhëna nga OFSP-ja (lista e vendeve me rrezik dhe rendi i veprimeve që duhet ndjekur në www.bag.admin.ch). Ata vendosen në vetizolim, kontaktojnë Mjekun kantonal dhe kthehen në institucionin e tyre vetëm pasi të ketë mbaruar koha e izolimit në fjalë dhe vetëm nëse nuk paraqesin asnjë shenjë. Mësuesit dhe drejtoritë nuk marrin masa ndaj nxënësve që mungojnë për shkak të vënies në karantinë.

Më shumë informacione:

- [Vendimi n°174 \(PDF, 512 Ko\)](#): "Dispozitat e zbatimit të masave sanitare dhe organizative në kuadrin e rifillimit të mësimin me prani në shkollë dhe kalimin e provimeve qysh nga 10 gushti 2020 në nivelin e mesëm II (Plani kantonal i mbrojtjes 2 i nivelit të mesëm II - COVID-19)."

A do të mbahen udhëtimet e klasave (kampet dhe daljet shkollore) më 2020-2021?

Këto veprimtari mbahen por me kusht që të zhvillohen në Zvicër. Arsimitarët vaudezë që përgatiten për të organizuar udhëtime studimore me nxënësit mund të konsultojnë udhërrëfyesin e udhëtimeve studimore të qëndrueshme që përfshijnë edhe ide shërbimesh e ndihmash (transportet, strehimin, veprimtaritë).

Për më tepër informacione:

- [Udhërrëfyesi i udhëtimeve studimore të qëndrueshme](#)

A do të mbahen udhëtimet jashtë vendit ?

Udhëtimet studimore, kampet dhe daljet e tjera jashtë vendit nuk lejohen më 2020-2021. Vende evropiane do të mund të zgjidhen përsëri për vitin shkollor 2021-2022, me kusht që të përdoren mjete transporti të ndryshme nga avioni.

Si mund ta vlerësoj unë gjendjen time apo atë të rrethit tim?

[CoronaCheck-u](#) është një mjet për të bërë vlerësimin e shpejtë të rrezikut tënd apo të njerëzve të rrethit tënd, dhe për të mësuar si të veprohet (<https://coronavirus.unisante.ch/>).

Loja video CoronaQuest ka dalë më 11 maj me rastin e fillimit të vitit shkollor. Për çfarë shërben ajo?

CoronaQuest-i është një lojë serioze. Qëllimi i saj është që të ngulisim dhe të forcojmë « gjestet mbrojtëse » te nxënësit, por edhe « të jetuarit së bashku », ndihmën për shokët, etj. Një ligë e re është krijuar me rastin e fillimit të vitit shkollor 2020-2021, me letra të propozuara nga nxënësit dhe mësuesit. Kjo lojë gjendet në linjë në 10 gjuhë, falas dhe shoqërohet nga një [fishë pedagogjike](#) që përshkruan veprimtaritë e ndryshme që ajo propozon për klasat 1 deri në 11P. Mund të luani në shkollë e jashtë saj, me shokët apo familjen tuaj, me telefona të zgjuar, tableta e ordinatore. Për të filluar një lojë, mjafton të shkoni në sitin www.coronaquest.game.

Për më tepër informacione:

- [Video paraqitjeje](#)

Për të mësuar më shumë

[Këshillat e OFSP-së](#) të ripërtërira në kohë reale dhe linja “Infos coronavirus” : +41 58 463 00 00 (çdo ditë, 24 orë në 24)

Një “Hotline” kantonale për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të popullsisë lidhur me koronavirusin : 0800 316 800 (çdo ditë, nga ora 8.00 deri në orën 20.00)

Për të ndjekur zhvillimin e gjendjes e për të marrë përgjigje për pyetjet tuaja, shkoni në sitin <https://www.vd.ch/coronavirus> dhe në sitin e qendrës përkatëse të formimit.